



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 1451/1 prot.

Tiranë më 12.09.2023

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr.5167/2 prot., datë 04.09.2023, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimin 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i këtij projektvendimi dhe i të gjithë dokumentacionin shoqërues, Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo Strategji në tërësi zbaton standardet e mbrojtjes së të dhënave personale. Megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve apo saktësimeve të mëposhtme.

Në të gjithë përmbajtjen e dokumenteve të zëvendësohet akronimi i Zyrës së Komisionerit nga “IDP” apo “KDIMDHP” në akronimin “KDIMDP”.

Në Matricën e Masave dhe Aktiviteteve të Strategjisë, lidhur me aktivitetin 3.2.6.5, me përmbajtje: “Përcaktimi i rregullave të mbrojtjes së dhënave personale” është parashikuar Zyra e Komisionerit si institucion përgjegjës për realizimin e këtij aktiviteti.

Për sa më lart sqarojmë se, Zyra e Komisionerit është autoriteti përgjegjës, i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron, zbatimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Në këtë kuptim, për realizimin e aktivitetit 3.2.6.5, institucioni ynë mund të jetë në rolin e institucionit i cili jep mendim/opinion për rregullat që kanë të bëjnë me të dhënat personale, të cilat duhet të hartohen dhe zbatohen nga autoritetet kompetente që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e viktimave të

krimin. Në këto kushte, sugjerojmë që në këtë pikë “KDIMDP” të jetë në rolin e “Institucionit partner” dhe jo si “Institucion përgjegjës”.

Gjithashtu, sugjerojmë të ri-formulohet aktiviteti i përcaktuar në pikën 3.3.1.2, me këtë përmbajtje:

“3.3.1.2 Organizimi i trajnimeve, workshop-eve me qëllim rritjen e aftësive të profesionistëve (psikolog, punonjës social, punonjës policie, prokurorë etj.) mbi zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit të të dhënave personale dhe mbi detyrimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale për viktimat e krimin.”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi